VENDIM
Nr. 111, datë 10.6.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "5GX ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 867/12 prot., datë 5.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi licencimin e shoqërisë '5GX Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "5GX Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 867 prot., datë 3.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 64, datë 12.4.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "5GX Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën me nr. 867/3 prot., datë 22.4.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo plotësuar pjesërisht.

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të depozituar nga shoqëria, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 92, datë 13.5.2024, vendosi zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar në lidhje me aplikimin e shoqërisë "5GX Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me qëllim zhvillimin e korrespondencës së mëtejshme me shoqërinë apo dhe planifikimin e një seance dëgjimore për të sqaruar dokumentacionin që ka mbetur ende për t'u plotësuar dhe depozitimin e tij në vijim në ERE.

- Me shkresën nr. 867/7 prot., datë 20.5.2023 dhe e-mail-in njoftues protokolluar më pas në ERE me nr. 867/8 prot., datë 28.5.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar zhvillimin e një seance dëgjimore, për plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të plotësuar pjesërisht prej saj.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 867/9 prot., datë 30.5.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3 germat "a", "b" dhe "c"; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "5GX Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "5GX Energy" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti